



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 533/ 10 prot.

Datë 20/06/2024

V E N D I M

Nr. 713/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.06/2024, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Infosoft Office*” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-94116-01-30-2024, me objekt: “*Shërbim i printimit dhe fotokopjimit*” me fond limit 6,563,666.67 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 12.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A.

Ankimues: Operatori ekonomik “*Rikon-AL*” SHPK me NIPT L22119010H dhe adresë: *Njësia Administrative Kashar, Rruga Ismail Qemali, Nd.40, H.28,1050, Yzberisht, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës SH.A
Adresa: L.17 Rruga “Dalip Peza”, Durrës.

Persona të interesuar: Operatori ekonomik “*Infosoft Office*” SHPK me NIPT J62426002Q dhe adresë: *Kodër Kashar, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8, Tiranë.*

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i

Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V e r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të,

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 31.01.2024 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-94116-01-30-2024, me objekt: “Shërbim i printimit dhe fotokopjimit” me fond limit 6,563,666.67 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 12.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A.

II.2. Në datë 12.02.2024 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 19.02.2024 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1. “Infosoft Office” ShPK	3.625.000 leke	kualifikuar
2. “Erisoni Company” ShPK	3.810.000 leke	skualifikuar

3. “RIKON-AL” ShPK	4.400.000 leke	kualifikuar
4. “PC STORE” ShPK	4.900.000 leke	kualifikuar
5. “BNT ELECTRONICS” ShPK	5.975.000 leke	kualifikuar

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 27.02.2024 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak, duke shpallur fitues shoqërinë “*Infosoft Office*” ShPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Në datë 04.03.2024 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dhe autoritetit kontraktor është protokolluar ankesa me numër elektronik A/2024/3855, datë 04.03.2024, dhe me nr. 533/2024 prot, datë 04.03.2024 e operatorit ekonomik “RIKON-AL” ShPK, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Infosoft Office*” ShPKnë procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 533/2, datë 05.03.2024, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “RIKON-AL” ShPK, mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur prej operatorit ekonomik “*Infosoft Office*” ShPKnë procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Me shkresën nr. 178/36 prot, datë 07.03.2024, protokolluar me tonën me nr. 533/3 prot datë 08.03.2024, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe vendimi për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “RIKON-AL” ShPK, në të cilin konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.8. Me shkresën nr. 533/4 prot., datë 22.05.2024 me objekt “*Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “RIKON-AL” SHPK*”, Komisioni i Prokurimit Publik me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur ka kërkuar nga autoriteti kontraktor dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria “*Infosoft Office*” SHPK për të justifikuar ofertën e tij ekonomike, e cila ka rezultuar anomalisht e ulët, si dhe dokumentacioni si në vijim: “*Kopje e fletës apo fletave të rregjistrit të protokollit të Institucionit tuaj, që vërteton datën e dorëzimit të dokumentacionit nga ana e shoqërisë “Infosoft Office” SHPK, dokumentacioni i kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor më datë 19.02.2024 nëpërmjetë Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE).*”

II.9. Me shkresën nr. 178/38 prot, datë 24.05.2024, protokolluar me tonën me nr. 533/5 prot datë 27.05.2024, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “*Infosoft Office*” SHPK për të justifikuar ofertën e tij ekonomike, e cila është anomalisht e ulët, si dhe kopje e fletës të rregjistrit të protokollit të autoritetit kontraktor, që vërteton datën e dorëzimit të këtij dokumentacioni.

II.10. Me shkresën nr. 533/6 prot., datë 11.06.2024 me objekt “*Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “RIKON-AL” SHPK*”, Komisioni i Prokurimit Publik me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur ka kërkuar nga autoriteti kontraktor informacion lidhur me datën se kur ka dorëzuar dokumentacionin fizik operatori ekonomik “*Infosoft Office*” SHPK pranë autoritetit kontraktor në vijim të kërkesës së datës 19.02.2024 të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave drejtuar këtij operatori ekonomik nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE), si dhe dokumentacionin si në vijim: “*Kopje e fletës apo fletave të rregjistrit të protokollit të Institucionit tuaj*”, që vërteton datën e dorëzimit të dokumentacionit nga ana e shoqërisë “*Infosoft Office*” SHPK, dokumentacioni i kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor më datë 19.02.2024 nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE).

II.11. Me shkresën nr. 178/40 prot, datë 12.06.2024, protokolluar me tonën me nr. 533/7 prot datë 14.06.2024, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni i entit prokurues lidhur me datën e dorëzimit të dokumentacionit fizik nga ana e operatorit ekonomik “*Infosoft Office*” SHPK pranë autoritetit kontraktor në vijim të kërkesës së datës 19.02.2024 të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave drejtuar këtij operatori ekonomik nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE), si dhe kopje e fletës të rregjistrit të protokollit të autoritetit kontraktor, që vërteton datën e dorëzimit të këtij dokumentacioni.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “*RIKON-AL*” ShPK si në vijim: “*... Pra rezulton e provuar që OE INFOSOFT OFFICE nuk i plotëson asnjë nga këto kritere që të justifikojë ofertën anomalisht të ulët sepse nuk është prodhues i mallrave, pjesëve të këmbimit, pajisjeve të printimit apo tonerave, nuk ka partneritete të njohura me prodhues të mëdhenj që mund të justifikonte çmimin e ulët të qirasë së pajisjeve, pajtueshmëria ligjore me mjedisin, punëdhënien, detyrimet fiskale janë kusht për fitimin e kontratës dhe është kompani me kapital privat 100% pra nuk ka ndihmë shtetërore. Dhe siç provohet nga pasqyrat financiare të publikuara në QKB, pozicioni financiar dhe të ardhurat-shpenzimet, krijojnë baza serioze për ta konsideruar ofertën e OE INFOSOFT OFFICE në këtë procedurë prokurimi si ofertë të papërgjegjshme dhe të papranueshme. Prandaj duke u bazuar për sa më sipër dhe mbështetur në LPP dhe RrPP, gjykojmë që oferta e OE INFOSOFT OFFICE është anomalisht e ulët dhe e paargumentuar, prandaj duhet skualifikuar*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 6 “*FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT*”, të dokumentave të tenderit të modifikuara, autoriteti kontraktor ka publikuar llojin dhe sasinë e shërbimeve objekt-prokurimi, si më poshtë vijon:

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Numri i printimeve dhe fotokopjimeve parashikohet të jetë 12 muaj nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të kontratës.

NR.	PËRSHKRIMI	SASIA E PRINTIMEVE	Çmimi/Njesi
1.	Shërbim printimi A4 bardh/zi	2 500 000	
2.	Shërbim printimi A3 bardh/zi	150 000	
3.	Shërbim printimi A4 me ngjyra	100 000	
4.	Shërbim printimi A3 me ngjyra	50 000	

Afatet e levimeve të pajisjeve: 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e nesërme e punës pas nënshkrimit të kontratës.

III.1.2. Në shtojcën 5 “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE”, të dokumentave të tenderit të modifikuar, autoriteti kontraktor ka publikuar specifikimet teknike të shërbimeve objekt-prokurimi, si më poshtë vijon:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

- Në cmimin e dhënë përfshihet Letra A3/A4. Duhet të përfshihen pajisjet (31 pajisje A4 & A3 bardhe zi dhe color), të gjithë tonerat e nevojshëm deri në përfundim të kontratës së mjaftueshme për printime deri në përfundimin e kontratës, drumet dhe cdo pjesë këmbimi tjetër për mirëfunksionimin e pajisjeve.
- Të gjithë tonerat duhet të jenë origjinale të llojit të printerit ose ekuivalent me të dhe të qëndrojnë stok në magazinën e institucionit. Të paktën një toner rezervë për cdo tip pajisje funksionale, duhet të jetë prezent në magazinën e institucionit.

- Operatori ekonomik duhet të përgjigjet brenda 4 (kater) orëve për difektet e pajisjeve. Në rastin kur pajisja nuk riparohet brenda 4 (kater) orëve, pajisja duhet të zëvendësohet brenda 24 oreve.
- Koha e Shërbimit do të jetë për 12 muaj.
- Pajisjet do të vendosen në ambjentet e UK Durres, UK Kavaje, UK Kruje, UK Shijak, UK Rrogozhine.
- Pajisjet duhet të funksionojnë 24 orë.
- Pajisjet duhet të funksionojnë si printer, fotokopje dhe skaner për te gjithë perdoruesit e mundshem duke u lidhur me rrjetin ekzistues të UK Durres, UK Kavaje, UK Kruje, UK Shijak, UK Rrogozhine.

Në rast të mosplotësimit të njëres nga kushtet e vendosura mësipër, Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për të skualifikuar apo anuluar kontratën në cdo moment.

Ujesjelles Kanalizime Durres per te realizuar shërbimin e printimit, fotokopjimit, skanimit kerkon keto pajisje sipas specifikimeve te poshte permendura

Nr.	Përshkrimi	Nj/M	Sasia
1	Pajisje Multifunksionale A3 me ngjyra	cope	15
2	Pajisje Multifunksionale A3 Bardh/Zi	cope	6
3	Pajisje Multifunksionale A4 Bardh/Zi	cope	10
4	Softëare		1
	Shuma e pajisjeve	cope	31

Specifikime teknike të pajisjeve të kërkuara:

*** 15 Fotokopje/Printer/Skaner(me ngjyra) A3**

“Funksioni”:	Fotokopje/printer/skaner me ngjyra
Shpejtësia “Kopje/Print per A4	≥33 ppm
Rezolucioni	Min 1200x1200
Vendosja e dokumentit “Document Feeder”:	ADF/RADF
Kopjim/printim në të dy faqet “Duplex copying/print.”:	Po
Formati i letrës “Media sizes”:	A6-A3
Memoria	≥ 2 GB
Cikli mujor I punes	26000 Flete
Kapaciteti mbajtes se leteres	≥1200 Flete
Kapaciteti ne dalje I letres	≥500 Flete
Formati i skanimit maksimal “Maximum scan size”:	A3
Porta e komunikimit “Interface”	High Speed USB 2.0 / Ethernet

Skanimi	Full Netëork kolor Skan (Skan to e-mail,skan to folder ,skan to FTP)
---------	--

*** 6 Fotokopje/Printer/Skaner A3 Bardh e zi**

“Funksioni”:	Fotokopje/printer/skaner
Shpejtësia “Kopje/Print per A4 B&Ë”:	≥36 ppm
Rezolucioni	min1200x1200
Vendosja e dokumentit “Document Feeder”:	ADF/DADF
Kopjim/printim në të dy faqet “Duplex copying/print.”:	Po
Formati i letrës “Media sizes”:	A6-A3
Memoria	≥ 1 GB
Kapaciteti mbajtes se leteres	≥1100 Flete
Kapaciteti ne dalje I letres	≥500 Flete
Formati i skanimit maksimal “Maximum scan size”:	A3 Kolor
Porta e komunikimit “Interface”	High Speed USB 2.0 / Ethernet
Finisher	Po
Skanimi	Full Netëork kolor Skan (Skan to e-mail,skan to folder ,skan to FTP)

***10 Fotokopje/Printer/Skaner(Bardh/Zi) A4**

“Funksioni”:	Fotokopje/printer/skaner me ngjyra
Shpejtësia “Kopje/Print per A4	≥55 ppm
Rezolucioni	Min 1200x1200
Vendosja e dokumentit “Document Feeder”:	ADF/RADF
Kopjim/printim në të dy faqet “Duplex copying/print.”:	Po
Formati i letrës “Media sizes”:	A6-A4
Memoria	≥1 GB
Cikli mujor I punes	180000 Flete
Kapaciteti mbajtes se leteres	≥1000 Flete
Kapaciteti ne dalje I letres	≥500 Flete
Formati i skanimit maksimal “Maximum scan size”:	A4

Porta e komunikimit "Interface"	High Speed USB 2.0 / Ethernet
Skanimi	Full Netëork kolor Skan (Skan to e-mail,skan to folder ,skan to FTP)

Specifikimet e Softëare	
1	Monitorimin i statusit te paisjeve ne kohe reale.
2	I afte per menaxhimin, kontrollin, gjurmimin, numerimin, auditimin, logimin si dhe raportimin per cdo printim, kopje apo skaner ne baze perdoruesi apo departamenti.
3	I pershtatshem me te gjithë sistemet e operimit si Eëindoës apo aplikacioneve Android/IOS etj.
4	Printimi I sigurte, autentikim I sherbimit nepermjet printimit me pin.
5	Autentikim printimi nepermjet kartave te check-in ekzistues te Personelit te Portit.
6	Pull dhe secure printing te implementohet ne paisjet qe kerkohet.
7	Mundesimi per upgrade automatik me ane te softëare te versioneve te fundit te firmëareve te pajisjeve.
8	Te mundesoje ëatermarking printing qe lejon vendosjen e nje vule dixhitale apo nje teksti te cfaredoshem ne cdo faqe printimi apo skanimi.

*Për këto operatori duhet të paraqesë katalog ose broshurrë
Specifikimet teknike të letrës A4, A3 (Brand i njohur Nderkombetar).

1.	Letër fotokopje A4, 79.5-80.5 gr/m2 ngjyra e bardhe	Risma 500 flete
2.	Letër fotokopje A3, 79.5-80.5 gr/m2 ngjyra e bardhe	Risma 500 flete

Specifikime Letër A4/A3 79.5-80.5 g/m2 e bardhe:

- Cilësi e parë me certifikatë ISO,
- CIE Bardhësi: 158-170% dhe pa lluster,
- Pesha e një fije 79.5-80.5 gr/m2, dhe nje rizme 500 fije x A4
- Përmasat te jene 210x297cm A4
- Multifunkionale - per fotokopje, printer, faks,
- Lageshtira: 3 - 5 %,
- Trashesia 103-115 mm
- Drita: ≥ 95%
- Shkelqimi: 101-115%

Ambalazhimi: Mbështjellje kundër lagështirës dhe kuti me kapacitet 5 risma, letra të mos bllokojë makinën fotokopjuese apo printerin, fax-in, të qëndrojnë e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit, të mos lëshojë pluhur letre pas printimit apo fotokopjimit, të jetë e përshtatshme për printim në të dyja anët, të plotësojë standardet që letra të mbahet për kohë të gjatë në arkiv, sipas ISO 9706, të mos jetë e ricikluar.

Shërbimi i printimit e fotokopjimit do të përfshijë: implementimin e pajisjeve nga operatori ekonomik, mirembajtjen e ketyre pajisjeve, furnizimin me mallra, (toner, pjese kembimi, konsumi dhe letër).

III.1.3. Në shtojcën 7 “*TERMAT E REFERENCES*”, të dokumentave të tenderit të modifikuara, autoriteti kontraktor ka publikuar termat e referencës të shërbimeve objekt-prokurimi, si më poshtë vijon:

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

- *Në cmimin e dhënë përfshihet Letra A3/A4. Duhet të përfshihen pajisjet (31 pajisje A4 & A3 bardhe zi dhe color), te gjithë tonerat e nevojshëm deri në përfundim të kontratës së mjaftueshme për printime deri në përfundimin e kontratës, drumet dhe cdo pjesë këmbimi tjetër për mirëfunksionimin e pajisjeve.*
- *Te gjithë tonerat duhet të jenë origjinale të llojit të printerit ose ekuivalent me të dhe të qëndrojnë stok në magazinën e institucionit. Të paktën një toner rezervë për cdo tip pajisje funksionale, duhet të jetë prezent në magazinën e institucionit.*
- *Operatori ekonomik duhet të përgjigjet brenda 4 (kater) orëve për difektet e pajisjeve. Në rastin kur pajisja nuk riparohet brenda 4 (kater) orëve, pajisja duhet të zëvendësohet brenda 24 oreve.*
- *Koha e Shërbimit do të jetë për 12 muaj.*
- *Pajisjet do të vendosen në ambientet e UK Durres, UK Kavaje, UK Kruje, UK Shijak, UK Rrogozhine.*
- *Pajisjet duhet të funksionojnë 24 orë.*
- *Pajisjet duhet të funksionojnë si printer, fotokopje dhe skaner për te gjithë perdoruesit e mundshem duke u lidhur me rrjetin ekzistues të UK Durres, UK Kavaje, UK Kruje, UK Shijak, UK Rrogozhine.*

Shpërndarja:SHRUKD

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: SHRUKD

III.1.4. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë KPP-së me shkresën protokolluar me tonën me nr. 178/38 prot., datë 24.05.2024, si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton, se KVO gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në aplikim të formulës mbi ofertën anomalisht të ulët ka konstatuar, se oferta e shoqërisë “Infosoft Office” SHPK është ofertë anomalisht e ulët. Në këto kushte më datë 13.02.2024, KVO-ja nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (SPE) i është drejtuar operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK me kërkesë për sqarim për ofertën anomalisht të ulët sipas nenit 93 të LPP-së, si vijon:

“Referuar procedurës së prokurimit me objekt "Shërbim i printimit dhe fotokopjimit", Të zhvilluar më datë 12.02.2024, ora 12:00, bazuar në Ligjin me nr.162 datë 23.12.2020, Neni 90 "Për Prokurimin Publik", VKM-në me Nr.285 date 19.05.2021, Neni 80 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar, si dhe VKM-se nr.710, datë 24.11.2021, Udhëzimin me Nr.7 datë 30.07.2021 "Për menyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike" në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), Dokumentat standarte të

tenderit, KVO mori në shqyrtim ofertat e paraqitura në mënyrë elektronike për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 82 Pika 4, të VKM-së me Nr.285 datë 19.05.2021 dhe dokumentave të paraqitura nga ana Juaj, gjatë procesit të vlerësimit konstatoi se oferta juaj rezulton anomalisht e ulët pasi është ulur më shumë se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nga sa më sipër referuar LPP, Nenit nr.93 Pika 2, ju kërkojmë që të paraqisni me shkrim brenda tri ditëve pune (brenda datës 16.02.2024 ora 15:30), dokumentacion e nevojshëm për justifikimin e vlerës së ofertës tuaj konkretisht:

Shpjegimet jepen veçanërisht për:

- a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;
- b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;
- c) originalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;
- d) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;
- e) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!”.

III.1.5. Në përgjigje të kërkesës së KVO, më datë 15.02.2024 nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (SPE) me shkresën e datës 15.02.2024 “Sqarim për ofertë anomalisht të ulët”, si dhe me shkresën datë 15.02.2023 me objekt: “Sqarim për ofertë anomalisht të ulët” të protokolluar pranë autoritetit kontraktor me nr. 178/28 prot, datë 16.02.2024, operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK ka paraqitur shpjegimet e tij me qëllim justifikimin/argumentimin e ofertës së tij ekonomike e cila ka rezultuar anomalisht e ulët, duke argumentuar si më poshtë:

“Nepërmjet sistemit elektronik ne datën 13.02.2024 ka mbërritur një kerkese nga ana juaj, përmes të ciles na kerkohet argumentim i ofertes anomalisht te ulet, te paraqitur nga Infosoft Office sh.p.k. ne tenderin me objekt “Shërbim i printimit dhe fotokopjimit” te dates 12.02.2024.

Per te sqaruar:

- a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

Shpjegojme: Per tju sqaruar lidhur me anen ekonomike te kesaj oferte po ju paraqesim nje analize te detajuar te kostos, me perlllogaritje per cdo artikull, dhe me te gjitha elementet perberese te cmimeve, mbeshtetur ne fatura blerje dhe zhdoganime per nje pjese te tyre te cilat jane blere me pare dhe nje pjese me oferta te marra nga furnitoret tane. Sa me siper vertetohet aftesia e shoqerise tone per te blere artikujt me cmimet e deklaruar dhe realizimin me sukses te kontrates.

Per te sqaruar:

- b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

Shpjegojme: Infosoft Office eshte kompani lider ne tregun shqiptar per tregtimin e artikujve te kancelerise, letres dhe tonerave, me nje pervoje me shume se 25 vjecare, si edhe nje

pervoje mbi 10 vjecare (qe ne fillimet e ketij koncepti) ne ofrimin e sherbimit te printimit per kliente te shumte shtetore dhe private. Kompania jone ka mundesi financiare te konsoliduara, me nje xhiro vjetore per vitin 2020: 894,144,598 leke, per vitin 2021: 979,602,980 leke, dhe per vitin 2022: 1,073,644.035 leke. Kjo na jep mundesine te perfitojme cmime shume favorizuese. Sa me lart, produktet objekt prokurimi, qe shoqeria jone ka ofertuar, jane konform te gjitha specifikimeve teknike te percaktuara ne DST. Me alternativa te ngjashme, te ofertuara ne kete procedure prokurimi, Infosoft Office ka kuotuar, fituar dhe realizuar me sukses proceduren me te rendesishme te furnizimit me tonera te Administrates Shtetore, zhvilluar nga Agjensia e Blerjeve te Perqendruara.

Proceduren e zhvilluar nga Agjensia e Blerjeve te Perqendruara sherbim printimi (Drejtoria e Pergjithshme e Burgjeve), Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve te Transportit Rrugor (DPSHTRR), etj.

Procedura ne te cilat oferta ka rezultuar anomalisht ulet si: Drejtoria Vendore e Policise Durrës (DVPD), Sherbimi per Ceshtjet e Brendshme dhe Ankesat (SHCBA), te cilat do t'i gjeni bashkelidhur.

Gjithashtu shoqeria jone ka realizuar me sukses nje sere kontratash ku kemi rezultuar me oferte anomalisht te ulet , si psh Bashkia Durrës, Universiteti i Tiranës, Prokuroria e Posacme e Krimet te Organizuar.

Qindra kontratat e realizuara me sukses ne shume vite pune tregojne qarte mundesine e Infosoft Office sh.p.k. per te realizuar, sherbime dhe furnizime ne kohe dhe cilesi, ne cdo rast kur oferta jone ka rezultuar anomalisht e ulet.

Per te sqaruar:

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

Shpjegojme:

Konfirmojme se artikujt e ofertuar nga kompania jone plotesojne te gjitha specifikimet teknike te kerkuara nga ju ne dokumentat e tenderit dhe te gjitha standartet nderkombetare te cilesise.

Permes dokumentave te paraqitur ne tender kemi marre persiper plotesimin e te gjitha specifikimeve te artikujve, gje qe e rikonfirmojme edhe nje here. Gjithashtu kemi paraqitur ne tender cdo dokument qe ju keni pare te arsyeshme te kerkoni, per tu siguruar per cilesine e produkteve, objekt prokurimi.

Per te sqaruar:

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

Shpjegojme:

Per t'ju konfirmuar qe kompania jone ploteson te gjitha detyrimet ligjore, po ju paraqesim nje vertetim te pageses se rregullt te detyrimeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore.

Kompania jone eshte e certifikuar sipas standarteve nderkombetare me ISO 9001 per Sistemin e Menaxhimin e Cilesise, ISO 45001 per Sistemin e Menaxhimit te Sigurise ne Pune dhe ISO 14001 per Sistemin e Menaxhimin te Mjedisit ne vendet ku ushtrojme aktivitetin apo ofrojme sherbimet (bashkangjitur).

Ne perputhje me legjislacionin e prokurimit publik, kerkojme nga ju qe te gjitha dokumentat shoqerues te permendura me lart, te administrohen si informacion konfidencial, te perdoren vetem per qellimin e kerkuar dhe te mos ju behen te ditura paleve te treta.

Duke ju falenderuar paraprakisht per bashkepunimin, mbetemi ne dispozicionin tuaj per cdo sqarim te metejshe dhe jemi te gatshem te paraqesim cdo dokumentacion shtese te nevojshem.

Per te sqaruar:

d) mundesine e ofertuesit per te marre ndihme shteterore.

Shpjegojme:

Shoqeria jone nuk eshte ne kushtet ku perfiton ndihme shteterore.

Bashkalidhur operatori ekonomik "Infosoft Office" ShPK ka paraqitur një analizë të detajuar kostoje, si më poshtë vijon:

		Analize Kosto							
1 Kosto fikse			sasia						
1	Ricoh MP C4053 (15 Cope)	(15 * x Euro)	15	€	x				
2	Lexmark MX 911de (6 Cope)	(6* x Euro)	6	€	x				
3	Lexmark MX 711 de (10 Cope)	(10 * x Euro)	10	€	x				
5	Software Modeli Ricoh	(1 * x Euro)	1	€	x				
6	Software Modeli Lexmark Instalime&konfigurime	(1 * x Euro) (x euro)	1	€	x				
7	Leter (Navigator)	(5600* x EURO)	5600	€	x				
Totali i kostove fikse					x				
1 Kosto fikse		Sasia		Kosto per Toner	Kosto Totale per Model Toneri				Kapaciteti Tonerit
1	Toner Black Ricoh MP C4503 (33K)			x	€	x	Flete B&W		33000 Kopje
2	Toner Cyan Ricoh MP C4503 (22.5K)			x	€	x	Flete Color		22500 Kopje
	Toner Magenta Ricoh MP C4503 (22.5K)			x	€	x	Flete Color		22500 Kopje
	Toner Yellow Ricoh MP C4503 (22.5K)			x	€	x	Flete Color		22500 Kopje
	Toner Black Lexmark MX911 (32.5K)			x	€	x	Flete B&W		32500 Kopje
	Toner Black Lexmark MX711 (25K)			x	€	x	Flete B&W		25000 Kopje
Kosto Totale Tonerash						x			
Kosto Administrative per 1 Vit						x			
Kosto Totale Fikse dhe Variabel ne Euro						x			
Shenime; Kursi i kembimit 1 Euro=105.00 leke		Kosto Totale Fikse dhe Variabel neLeke				x			
Marzh rreth						x			
Cmimi i ofertes ne Leke							3,625,000 leke		

FORMULARI I KOSTOS

Shërbimi	Përshkrimi i shërbimi	Sasia	kosto për njësi	kosto total për shërbim printimi (3 x 4x)
	Shërbim printimi A4 bardh/zi	2500000	ALL -	ALL -
	Shërbim printimi A3 bardh/z	150000	ALL -	ALL -
	Shërbim printimi A4 me ngjyra	100000	ALL -	ALL -
	Shërbim printimi A3 me ngjyra	50000	ALL -	ALL -
Kosto Totale				x
Fitimi Rreth 20.7 %				
Vlera totale				3,625,000 leke

Dokumentacion provues si më poshtë vijon:

Vërtetim xhiro për vitet 2020, 2021 dhe 2022, Nr. T09872720, datë, 01.02.2024, të lëshuar nëpërmjet portalit E-albania..

Vërtetim për pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësor Nr. T09905213, datë, 07.02.2024, të lëshuar nëpërmjet portalit E-albania.

Kontratë nr. 940/3 prot, datë 02.06.2021, të lidhur ndërmjet shoqërisë “Infosoft Office” ShPK dhe autoritetit kontraktor Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, me objekt: “Shërbim printimi e fotokopjimi për SHÇBA-në”, me vlerë 1.499.836,56 leke me-TVSH.

Kontratë nr. 30/1 prot, datë 14.01.2022, të lidhur ndërmjet shoqërisë “Infosoft Office” ShPK dhe autoritetit kontraktor Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, me objekt: “Shërbim printimi e fotokopjimi për SHÇBA-në”, me vlerë 2.432.800,32 leke me-TVSH.

Kontratë nr. 01 prot, datë 26.02.2021, të lidhur ndërmjet shoqërisë “Infosoft Office” ShPK dhe autoritetit kontraktor Drejtoria e Policisë Vendore Durrës, me objekt: “Shërbim printimi i mnaxhuar për Drejtorinë e Policisë Vendore urrës dhe insitucionet vartëse të saj, Komisariati Policisë Durrës, Stacioni i Policisë Manze, Stacioni i Policisë Plazh, Komisariati Policisë Shijak, Komisariati Policisë Krujë, Stacioni i Policisë Fushë Krujë ”, me vlerë 1.326.220,5 leke pa-TVSH.

Deklaratë doganore “IM 4” datë 03.03.2023 me importues shoqërimë ‘Infosoft Office’ SHPK, ku vërtetohet se ka importuar pajisje printuese/fotokopjuese, shoqëruar me faturë blerje, certifikatë origjine dhe flete hyrje në magazinë.

Faturë blerje tonera nr. 1494/2023, datë 17.03.2023”

Deklaratë doganore “IM 4” datë 02.09.2022 me importues shoqërimë ‘Infosoft Office’ SHPK, ku vërtetohet se ka importuar tonera të markës Lexmark, shoqëruar me faturë blerje, certifikatë origjine dhe flete hyrje në magazinë.

Deklaratë doganore “IM 4” datë 26.05.2023 me importues shoqërimë ‘Infosoft Office’ SHPK, ku vërtetohet se ka importuar pajisje printuese/fotokopjuese, shoqëruar me faturë blerje, certifikatë origjine dhe flete hyrje në magazinë.

Deklaratë doganore “IM 4” datë 23.11.2023 me importues shoqërimë ‘Infosoft Office’ SHPK, ku vërtetohet se ka importuar pajisje printuese/fotokopjuese, shoqëruar me faturë blerje, certifikatë origjine dhe flete hyrje në magazinë.

Faturë blerje letre FT R24/013878, datë 28.02.2024 me objekt blerje letre A4

Certifikatë ISO 22301:2019, lëshuar nga trupa certifikuese AQScert, me numër certifikate: AQS/BC/82162022.

Certifikatë ISO 27001:2013, lëshuar nga trupa certifikuese AQScert, me numër certifikate: AQS/SI/70862021.

Certifikatë ISO 45001:2018, lëshuar nga trupa certifikuese AQScert, me numër certifikate: AQS/S/107582023.

Certifikatë ISO 9001:2015, lëshuar nga trupa certifikuese AQScert, me numër certifikate: AQS/Q/72242021.

Certifikatë ISO 14001:2015, lëshuar nga trupa certifikuese AQScert, me numër certifikate: AQS/A/107572023.

Certifikatë ISO 20000-1:2018, lëshuar nga trupa certifikuese AQScert, me numër certifikate: AQS/IT/70872021.”.

III.1.6. Në nenin 93 pika 1 dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:

“1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj [...]”

III.1.7. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;*
- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.*
- Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPPsë.*
- Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.”.*

III.1.8. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, si edhe nga përlllogaritjet e kryera, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se oferta ekonomike në vlerën prej 3.625.000 lekë pa TVSh, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e ulët. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomik për ofertën anomalisht të ulët duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2, të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen

njëkohësisht dhe në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me *mundësinë* e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2, të nenit 93 të *lex specialis*.

Në interpretim literal të nenit 93, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve, ose për kryerjen e punës. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi. Ata duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi si edhe së fundmi të argumentojnë apo provojnë *mundësinë* e tyre për të përfituar ndihmë shtetërore. Referuar nenit 93, pika 3 të LPP-së, autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. **KPP gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. KPP gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime, ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP thekson se referuar nenit 2 gërma “b” “Qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se; “Qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale**”. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës, që mund të vijë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përllogaritjes të parashikuar në ligj. Sa më sipër, referuar rastit në fjalë dhe themelit të kërkimit të operatorit ekonomik ankimues,

KPP gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuara pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit përmbushin në mënyrë të detyrueshme katër kushtet e para kumulative të parashikuara nga neni 93, pika 2 i LPP-së, si dhe *mundësinë* për të përmbushur kushtin e pestë, mospërmbushja e të cilit nuk përbën shkak për dështimin e operatorit ekonomik në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

III.1.9. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, në mbështetje të ofertës anomalisht të ulët të paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, rezulton, se ky i fundit është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Konkretisht, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, ka paraqitur si dokumentacion mbështetës ose provues: argumentimin e ofertës në mënyrë narrative përmes shkresës datë 15.02.2023 me objekt: *“Sqarim për ofertë anomalisht të ulët”* të protokolluar pranë autoritetit kontraktor me nr. 178/28 prot, datë 16.02.2024 ku ka shpjeguar të gjitha elementet e ofertës së paraqitur prej tij dhe duke e justifikuar çmimin e ofertuar bazuar në disa komponentë. Konkretisht ankimuesi ka deklaruar se: *“Permes dokumentave te paraqitur ne tender kemi marre persiper plotesimin e te gjitha specifikimeve te artikujve, gje qe e rikonfirmojme edhe nje here. Gjithashtu kemi paraqitur ne tender cdo dokument qe ju keni pare te arsyeshme te kerkoni, per tu siguruar per cilesine e produkteve, objekt prokurimi.*

Per te sqaruar:

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

Shpjegojme:

Per t’ju konfirmuar qe kompania jone ploteson te gjitha detyrimet ligjore, po ju paraqesim nje vertetim te pageses se rregullt te detyrimeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore.

Kompania jone eshte e certifikuar sipas standarteve nderkombetare me ISO 9001 per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise, ISO 45001 per Sistemin e Menaxhimit te Sigurise ne Pune dhe ISO 14001 per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit ne vendet ku ushtrojme aktivitetin apo ofrojme sherbimet (bashkangjitur).

Ne perputhje me legjislacionin e prokurimit publik, kerkojme nga ju qe te gjitha dokumentat shoqerues te permendura me lart, te administrohen si informacion konfidencial, te perdoren vetem per qellimin e kerkuar dhe te mos ju behen te ditura paleve te treta.

Duke ju falenderuar paraprakisht per bashkepunimin, mbetemi ne dispozicionin tuaj per cdo sqarim te metejshe dhe jemi te gatshem te paraqesim cdo dokumentacion shtese te nevojshem.

Per te sqaruar:

d) mundesine e ofertuesit per te marre ndihme shteterore.

Shpjegojme:

*Shoqeria jone nuk eshte ne kushtet ku perfiton ndihme shteterore.... Përveç kësaj, KPP vëren se ankimuesi në mbështetje të deklarime më sipër ka paraqitur **Analizë kosto** për të gjithë shërbimet objekt-prokurimi, duke bërë analizë kostoje sipas specifikimeve teknike të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor në Shtojcën 5 “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE” të dokumentave të tenderit dhe konkretisht duke analizuar koston e pajisjes forokopjuese/printuese, koston e tonerit që do të vendoset në këto pajisje, koston e letrës që do të përdoret për realizimin e shërbimit, si dhe koston e instalimit dhe mirëmbajtjes së tyre.*

Gjithashtu operatori ekonomik ofertues “Infosoft Office” SHPK në mbështetje të kësaj analizë ka paraqitur deklarata doganore të importit të pajisjeve fotokopjuese/printuese,, fatura blerje të tonerave dhe letrës A4 që do të përdoren në këto pajisje, kontrata të mëparshme me objekt të njëjtë me objektin e prokurimit, vërtetim realizimi, Certifikata ISO, Vërtetim numër punonjësish dhe Vërtetim xhiro..

KPP gjykon se, operatori ekonomik ofertues “Infosoft Office” SHPK në rastin konkret ka arritur nëpërmjet dokumentacionit provues sa më sipër të argumentojë në mënyrë bindëse të gjitha elementet e ofertës së tij. Përveç argumentimit në formën e një narrative ku shpjegon çmimin e ofertuar prej tij dhe elementët favorizues që disponon të tilla si eksperiencia e gjatë në treg, realizimi i një sërë kontratash me subjekte të ndryshme, lidhjet me prodhuesit dhe mundësisë së ofertimit edhe me tonera që do të përdorë, duke i provuar të gjitha deklaratimet e tij me dokumentacion justifikues si fatura tatimore, deklarata doganore, dhe kontrata të ngjashme të realizuara më parë, ky ofertues ka paraqitur edhe analizën e detajuar të kostos në përmbushje të gërmës a) të nenit 93 të LPP ku flitet për anën ekonomike të **metodës së ndërtimit dhe paraqitjes së analizës së kostos për të gjitha elementet**. Operatori ekonomik ankimues ka detajuar analizën e kostos në trajtë analitike, duke e argumentuar me prova dhe fakte dhe ka justifikuar çmimin e ofertuar për çdo zë (përfshirë koston e pajisjeve fotokopjuese/printuese, koston e tonerave, koston e letrës, që do të vërë në dispozicion të autoritetit kontraktor për realizimin e shërbimit objekt-prokurimi sipas specifikimeve teknike dhe termave të referencës, koston e instalimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve dhe kostot administrative të parashikuara për realizimin e këtij shërbimi për 1 (një) vit dhe marzhin e fitimit. Në këtë kuptim, KPP gjykon se ankimuesi ka përmbushur të gjitha kushtet kumulative të parashikuara nga neni 93 i LPP-së.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “RIKON-AL” SHPK nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “RIKON-AL” ShPK si në vijim: “... VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK” , në nenin 26 ka parashikuar se pas publikimit të klasifikimit dhe përpara njoftimit të fituesit, ofertuesit të kualifikuar si i pari, i kërkohet dhe dorëzon brenda 5 ditësh dokumentacionin shoqëruar të ofertës, të noterizuar ose origjinal. Ndërkohë po sipas nenit 26 , duhen dorëzuar në AK, dokumentat e përmbledhura në formularin e vetëdeklarimit, të noterizuara ose origjinale. Ne si OE RIKON-AL, së pari, gjykojmë se OE INFOSOFT OFFICE i ka dorëzuar dokumentat e tenderit, referuar nenit 26 të VKM, me vonesë dhe duke shkelur afatet e përcaktuara, pasi publikimi i renditjes së OE në SPE është kryer me datë 19/02/2024 dhe njoftimi paraprak i fituesit është kryer në datën 27/02/2024, pra pas 9 ditësh nga publikimi i renditjes.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), konstatohet se në datën 19.02.2024, komisioni i vlerësimit të ofertave ka bërë vlerësimin e ofertave të dorëzuara dhe në po këtë datë ka njoftuar elektronikisht operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave të tyre, si më poshtë vijon:

- | | | |
|---------------------------|----------------|--------------|
| 1. “Infosoft Office” ShPK | 3.625.000 leke | kualifikuar |
| 2. “Erisoni Company” ShPK | 3.810.000 leke | skualifikuar |

3. “RIKON-AL” ShPK	4.400.000 leke	kualifikuar
4. “PC STORE” ShPK	4.900.000 leke	kualifikuar
5. “BNT ELECTRONICS” ShPK	5.975.000 leke	kualifikuar

III.2.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dërguar me shkresën nr. 178/40 prot, datë 12.06.2024, protokolluar me tonën me nr. 533/7 prot datë 14.06.2024, si dhe verifikimeve të bëra në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), konstatohet se komisioni i vlerësimit të ofertave më datë 19.02.2024 i ka kërkuar elektronikisht operatorin ekonomik ofertues “Infosoft Office” SHPK paraqitjen brenda 3 (tre) ditëve të dokumentacionit, sipas parashikimeve të nenit 26, pika 6 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

III.2.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dërguar me shkresën nr. 178/40 prot, datë 12.06.2024, protokolluar me tonën me nr. 533/7 prot datë 14.06.2024, konstatohet se operatorin ekonomik ofertues “Infosoft Office” SHPK më datë 21.02.2024 ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar, sipas parashikimeve të nenit 26, pika 6 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dokumentacion i cili është protokolluar pranë autoritetit kontraktor me nr. 178/30 prot, datë 21.02.2024.

III.2.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 27.02.2024 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak, duke shpallur fitues shoqërinë “Infosoft Office” ShPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.2.5. Në nenin 82 pika 5 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:

“5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna. Rregulla të posaçme për këtë pikë parashikohen në rregullat e prokurimit publik.”

III.2.6. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 6 dhe 7 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të 19 parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h” “i”, “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të

huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik, si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”.

III.2.7. Refruar pretendimit të mësipërm të operatorit ekonomik ankimues “RIKON-AL” SHPK lidhur me datën e dorëzimit të dokumentacionit nga ana e operatorit ekonomik ofertues “Infosoft Office” SHPK, Komisioni gjykon se ky pretendim i ankimuesit nuk qëndron, pasi referuar informacionit të autoritetit kontraktor, verifikimeve të bëra në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) konstatohet se komisioni i vlerësimit të ofertave sipas parashikimeve të nenit 82, pika 5 të LPP-së dhe parashikimeve të nenit 26 pika 6 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar më datë 19.02.2024 i ka kërkuar elektronikisht ofertuesit “Infosoft Office” SHPK paraqitjen brenda 3 (tre) ditëve të dokumentacionit, sipas parashikimeve të nenit 26, pika 6 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK brenda afati 3 (tre) ditor më datë 21.02.2024 ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar, duke përmbushur parashikimet e nenit 26, pika 6 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Sa më lart, pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në 10 një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, te Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “RIKON-AL” ShPK për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-94116-01-30-2024, me objekt: “Shërbim i printimit dhe fotokopjimit” me fond limit 6,563,666.67 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 12.02.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “RIKON-AL” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri